



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

Kom.Dh.Shk.II.nr.979/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Dren Rogova, anëtarë, në konfliktin administrativ NT Nedri Commerce nga Ferizaj kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, vlersim doganor, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.2687/2018 të datës 17.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04.05.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e papabuar ankesa e paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2687/2018 datës 17.11.2020, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NT Nedri Commerce nga Ferizaj, është anuluar Aktvendimi nr.07.3/1440/2014 i datës 17.10.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe është obliguar e paditura që paditësit t,ia kthej shumën prej 1,794.17€ të paguar më tepër në emër të detyrimeve importuese doganore për mallin e importuar përmes Deklaratës Doganore R-9780 dt.29.09.2014 të Z.B.D.Ferizaj.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ushtron e paditura, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes esenciale të dispozitave ligjore procedurale,

vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprohet ankesa e bazuar në ligj, të prishet aktgjykimi A.nr.2687/18 dt.17.11.2020 si i pabazuar në ligj, ta refuzon padin dhe kërkespadin e paditësit në tërsi si të pabazuar në ligj, ose t,ia kthej lëndën gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Gjykata nuk ka administruar prova për të vërtetuar drejt gjendjen faktike, por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerr konkluzion të gabuar duke aprovuar padinë e paditësit. Aktgjykimi përmban shkelje të dispozitave materiale respektivisht të nenit 34 të Kodit Doganor dhe të Akizave të Kosovës. Në bazë të analizimit të dokumentit unik doganor të deklaruar, shihet se deklaruesi i mallit ka deklaruar mallin në fjalë por me çmim më të ulët dhe se Dogana e Kosovës ka disponuar të dhëna për mallin, por me çmim më të lartë se ai i deklaruar.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë nr.07.3/1440/2014 i datës 17.10.2018 2019, në rivendosje, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë NT Nedri Commerce nga Ferizaj, për rishqyrtimin e vendimit R-9780/29.09.2014 të ZBD Ferizaj. Në arsyetim të vendimit administrativ theksohet se Zyra doganore ka vepruar drejt kur ka vlerësuar mallin bazuar në metodën e 3 të vlersimit neni 34 par.2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave, respektivisht të dhënave të disponueshme në bazë të procesit të vlersimit të bërë sipas DUD-it R-8827/08.09.2014. Dogana në rivendosje konstaton se malli kontestues nuk mund të rivlersohet sipas nenit 33 respektivisht vlerës së transaksionit, andaj aktvendimi sjellet në pajtim me nenin 34 paragrafi 2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Paditësi NT Nedri Commerce nga Ferizaj, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatë të shkallës së parë, e cila në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor me dt.17.11.2020, dhe pas administrimit të provave për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr

aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, e anulon aktvendimin kontestues të organit të paditur, dhe e obligon te padituren që paditësit t,ia kthej shumën prej 1,794.17€ të paguar më tepër në emër të detyrimeve importuese doganore për mallin e importuar përmes Deklaratës Doganore R-9780 dt.29.09.2014 ZBD Ferizaj. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar vendimin duke u referuar në nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave e cila dispozit parasheh se “Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin e vërtet të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë” dhe dispozitat e nenit 123 par.1 pika (a) të U.A. nr.11/2009. Gjykata nuk pajtohet me vendimin e të paditures, për arsye se paditësi ka paraqit gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë fazës së zhdoganimit të mallit lëndor, faturën si dhe transaksionet bankare, që dëshmojnë çmimin realisht të paguar për mallin lëndor, e të cilat dokumente përputhen plotësisht në kuptim të vlerës së transaksionit për pagesën e faturës së mallit lëndor në kuptim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Dhomat e Shkallës së Dytë, e pranon si të rregullt dhe të bazuar në ligj, aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, për arsye se Aktgjykimi nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, Kolegji i Dhomës së Dytë, nuk i aprovoi, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Në ankes e paditura nuk ka konkretizuar shkeljet e dispozitave ligjore procedurale të ndodhura gjatë procedurës së konfliktit administrativ nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë nuk i aprovoi, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë rast provat-të dhënat e disponueshme të prezantuara nga e paditura nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative. Ngase gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi në procedurën administrative tek e paditura, por edhe në këtë konflikt administrativ ka paraqitur dokumentacionin valid dhe të mjaftueshëm si provë për DUD-in R-9780 dt.29.09.2014 të ZBD Ferizaj, faturën e mallit, transaksionin bankar, me të cilat dokumentacione dëshmohet se është paguar vlera e mallit të kontraktuar dhe të gjitha këto dokumentacionet rezultojnë të jenë të harmonizuara sa i përket vlerës së mallit të importuar në kuptim të nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109.

Kolegji e vlerëson të papranueshëm pretendimin e te paditures në ankes, se deklarata eksportuese është dokument esencial në kompletimin e lëndës, pasi që ky pretendim nuk gjen mbështetje në legjislacionin doganor.

Prandaj, pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave ligjore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ky Kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë pa bazuar dhe pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, Aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Andaj, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.979/2022 datë 04.05.2023

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,  
Krenar Berisha